

Deri te:

Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit Juridik

## VLERËSIM I KOMISIONIT MBI DISERTACIONIN E DOKTORATURËS

Në bazë të vendimit nr.13-541/2 të datës 03.09.2020 të Këshillit mësimor-shkencor të fakultetit Juridik, për formimin e komisionit për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës, si dhe në bazë të nenit 62 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat për regjistrim dhe studim në ciklin e tretë të studimeve – studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës, komisioni në përbërje:

1. Prof. dr. QebirAvziu, kryetar;
2. Prof. dr. JusufZejneli, anëtar;
3. Prof. dr. FeratPolisi, anëtar;
4. Prof. dr. AliMusliu, anëtar;
5. Prof. dr. Afrim Osmani, mentor

Pasi vlerësoj punimin e doktoraturës me temë “Roli i Shqipërisë në bashkëpunim ndërkombëtar në luftimin e krimit të organizuar”, të kandidatit mr.sc. Anton Bardhaj, paraqet këtë:

## R A P O R T

për vlerësimin e punimit të doktoraturës

### 1. Lënda e hulumtimit

Krimi ekziston po aq sa qytetërimi njerëzor, dhe gjithmonë ka pasur nevojë për të mbrojtur individin, si dhe shoqërinë në tërësi, nga efektet e tij shkatërruese. Meqenëse krimi gjithmonë dhe në çdo shoqëri, pavarësisht strukturës socio-politike dhe zhvillimit ekonomik, ka përfaqësuar një problem të madh (mund të thuhet dhe të pazgjidhshëm), çdoherë ekziston interesit

i vazhdueshëm i filozofëve, juristëve dhe i shkencëtarëve për këtë fenomen. Kjo gjë ka rezultuar së pari, në shfaqjen e ideve të ndryshme që përpiqen të jasin përgjigje në pyetjen se, përsë disa njerëz i shkelin ligjet dhe normat e tjera shoqërore, ndërsa, të tjerët nuk e bëjnë këtë gjë, dhe pastaj, në shfaqjen e shumë teorive që shpjegojnë krimin. Ekzistojnë botëkuptime të ndryshme mbi krimin. Njëra prej ndarjeve themelore të kriminalitetit është ajo që dallon krimin e përgjithshëm, krimin e organizuar, krimin politik dhe krimin ekonomik, e cila ndarje është më e pranueshme nga aspekti i hetimit të aktiviteteve kriminale dhe formave të manifestimit, si dhe nga aspekti i aktiviteteve operative në parandalimin dhe luftimin e krimit nga ana e organeve për zbatimin e ligjit.

Në nivelin global nuk ka pasur një kuptim të përgjithësuar sa i përket krimit të organizuar deri në vitin 2000, kur për herë të parë është aprovuar Konventa e Kombeve të Bashkuara për Luftimin e Krimit të Organizuar. Kjo konventë paraqet konturat e përkufizimit të krimit të organizuar si dhe definon elementet përbërëse të kësaj vepre penale. Sipas kësaj konverte, krimi i organizuar përkufizohet si: “një grup i strukturuar prej tre ose më shumë personash, që veprojnë në bashkëpunim, me qëllim që të sigurojnë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, një përfitim financiar ose një përfitim tjetër material”. Konventa në fjalë i përmban edhe protokollet shtesë të cilat në mënyrë specifike adresojnë çështje që kanë të bëjnë me:

1. Parandalimin, hetimin dhe dënimin e trafikimit të personave;
2. Kontrabandimin me migrantë;
3. Prodhimi i kundërligjshëm dhe trafikimi me armë, i pjesëve të tyre dhe i municionit.

Është me rëndësi, të shqyrtohen shkaqet politike dhe sociale që favorizojnë zhvillimin e krimit të organizuar në rajon. Këto para së gjithash ndërlidhen me faktin se, vendet e Ballkanit kanë kaluar kryesisht nëpër fazën e luftës dhe dhunës, se situata ekonomike është e dobët ose e paqëndrueshme dhe se korrrupsioni është i përhapur. Nga ana tjetër, si faktorë që vepron pozitivisht në luftën kundër krimit të organizuar është perspektiva e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, gjë që krijon presion për zbatimin e reformave, si dhe bashkëpunimin e ndërsjellë në mes të vendeve të rajonit. U theksua se trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore dhe korrrupsioni mbeten probleme të mëdha, por që gjithnjë e më shumë, ndoshta problemi qendror i Evropës Juglindore bëhet krimi ekonomik që pengon seriozisht zhvillimin ekonomik të rajonit. Kontradiktat kanë të bëjnë me shanset për të marrë seriozisht kuptimin e krimit të organizuar në Ballkan. Disa ekspertë dhe përsaqësues të organizatave ndërkombëtare konsiderojnë se, në të

gjitha vendet është krijuar një "masë kritike" e atyre forcave që janë të gatshëm për të zhvilluar seriozisht luftën kundër krimit të organizuar. Mirëpo, poashtu, është vënë në dukje edhe kundërshtimi i kësaj pikëpamjeje, se kjo "masë kritike" në Ballkan ende nuk është krijuar, dhe se krijimi i saj varet kryesisht nga reformat themelore të sektorit të sigurisë (policia, ushtria, shërbimi i sigurimit shtetëror) dhe gjyqësorit. Në mënyrë që ajo të kryhet, së pari duhet të arrihet një konsensus politik për domosdoshmërinë e saj.

## 2. Qëllimi i hulumtimit

Objekt i trajtimit në këtë temë të doktoraturës është studimi kritik i rolit të Shqipërisë në bashkëpunimin ndërkombëtar në luftimin e krimit të organizuar. Krimi i organizuar konsiderohet si kërcënim ndaj sigurisë së brendshme si dhe asaj ndërkombëtare. Ky kërcënim mund të manifestohet në forma të ndryshme në përputhshmëri me zhvillimin e jetës ekonomike dhe shoqërore, sidomos në kushtet e globalizmit. Aktivitetet e krimit të organizuar në periudhën e globalizimit janë perfekcionuar shumë, sepse shumë grupe të krimit të organizuar operojnë me mjete teknike shumë të sofistikuara, e që është vështirë t'iu bihet në gjurmë. Krimi i organizuar në formën më të thjeshtë ka formën e një grupei kriminal i cili kyçet në aktivitete kriminale në forma të ndryshme. Përmes aktiviteteve trans-nacionale grupet e krimit të organizuar janë bërë protagonistë kryesorë në industritë ilegale, siç janë: prodhimi i drogës dhe trafikimi me qenie njerëzore të cilat kanë shtrirje globale dhe nganjëherë kanë profitin më të madh se Bruto Prodhimi Vendor i disa shteteve.

Rrjetet ndërkombëtare kriminale, po ashtu kanë fleksibilitet që shpejt dhe me kreativitet t'iu adaptohen përpjekjeve të organeve për zbatimin e ligjit. Këto grupe janë në gjendje që me sukses t'i shmanget përpjekjeve të organeve për zbatim të ligjit e sidomos organeve përgjegjëse për parandalim dhe luftim të krimit përmes operacioneve të cilat janë të përfshira në arenën ndërkombëtare duke i kaluar shumëherë kufijtë kombëtarë të shteteve. Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfëria, gjithashtu kontribuojnë në krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti.

Duke pasur parasysh deficitet ekzistuese të analizave teorike dhe empirike si dhe fondin e arritur të njojurive shkencore mbi këtë problematikë nga aspekti i perspektivës dhe strategjisë së kërkimit shkencor teorik dhe metodologjik që do të jetë baza e kësaj teze të doktoraturës, këtu do

të paraqiten dy qëllimet, objektivat dhe detyrat kryesore shkencore të kësaj teze të doktoraturës, edhe atë:

1. Objktivi shkencorme të cilin duhet të rritet fondi ekzistues i njojurive shkencore në lidhje me këtë temë të hulumtimit. Kjo gjë nënkupton përcaktimin e nivelit të njojurive shkencore që synon të arrihet përmes kërkimit shkencor dhe që do të përfshihet në rezultatet e hulumtimit të këtij fenomeni. Qëllimi i hulumtimit kualitativ është që përmes mbledhjes së të dhënave të realizohet përshkrimi shkencor i këtij fenomeni kërkimor, në mënyrë që, më pas, rezultatet e përshkrimit analistik të përdoren për analizën e fenomenit të hulumtuar.

2. Objktivi pragmatiki cili rrjedh prej dy bazave. E para ndërlidhet me njourinë shkencore mbi objektin e hulumtimit, dhe tjetra, ndërlidhet me aplikimin e drejtpërdrejtë të njojurive shkencore përgjatë proceseve dinamike të ndryshimit të sistemit normativ ligjor si dhe aplikimin e saj për të eliminuar mospërputhjet në mes të problemeve institucionale në fushën e krimit të organizuar dhe të drejtës penale si dhe zgjidhjen e tyre. Hulumtimi shkencor duhet të ofrojë njouri të besueshme shkencore mbi zhvillimin e të drejtës penale si dhe ndikimin e saj në gjendjen dhe perspektivat e krimit të organizuar. Përveç kësaj, rezultatet e këtij hulumtimi do të jenë gjithashtu një bazë për aktualizimin e sérishëm si dhe propozimin e zgjidhjeve të caktuara të cilat do të përmirësonin ndjeshëm luftimin e krimit të organizuar dhe do të plotësonin të drejtën penale. Ky hulumtim synon të ofrojë zgjidhje të mundshme mbi efektet negative të krimit të organizuar duke parandaluar dhe zvogëluar pasojat e dëmshme të krimit global.

Në përputhje me temën e hulumtimit, në bazë të objektivit të caktuari shkencor dhe pragmatik, konstatohen detyrat vijuese të hulumtimit në këtë tezë të doktoraturës:

1. Përkufizimi konceptual i krimit të organizuar dhe zhvillimi i tij historik;
2. Sa është përbushur prevencioni i përgjithshëm ose gjeneral (luftimi i krimit të organizuar);
3. Nxjerra e shembujve nga praktika gjyqësore e Republikës së Shqipërisë lidhur me shqiptimin e dënameve mbi krimin e organizuar;
4. Të demonstrohet se, efektet negative të krimit të organizuar mund të parandalohen përmes luftimit të tij; dhe
5. Të demonstrohet nëse, e drejta penale ndikon në reduktimin e shkallës së krimit të organizuar.

### **3. Aplikimi i metodave shkencore**

Shfletimi i literaturës parashtron një bazë të gjerë konsultuese të materialeve bibliografike të tanishme dhe të mëhershme mbi krimin e organizuar dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në luftimin e tij. Metodat kualitative që do të shfrytëzohen në këtë punim janë: metoda historike, metoda krahasuese, metoda e studimit të rasteve individuale (casestudy), metoda normative si dhe metoda të tjera. Metoda historike, mundëson që të njohim shtrirjen në rrafshin historik të krimtit të organizuar në Republikën e Shqipërisë. Me anë të saj do të kuptojmë paraqitjen dhe zhvillimin e krimtit të organizuar në një rrafsh më të gjerë kohor. Metoda krahasuese, do të na krijojë hapësirë për t'i krahasuar legjisacionet përkatëse penale në luftimin e krimtit të organizuar. Kjo metodë vë në pah ngjashmëritë dhe dallimet mes sistemeve juridike. Gjithashtu, ndihmon në krahasimin e harmonizimit që ekziston midis rregullave ligjore në luftimin e krimtit të organizuar. Metoda e studimit të rasteve individuale (casestudy), mundëson studimin e rolit të Shqipërisë në bashkëpunimin ndërkombëtar në luftimin e krimtit të organizuar në një kontekst më të gjerë përfshi rastet nga praktika gjyqësore e Shqipërisë. Metoda normative, na mundëson trajtimin e thelluar të rregullave juridike të së drejtës penale vendore dhe ndërkombëtare mbi krimin e organizuar dhe luftimin e tij. Kjo metodë tenton që të nxirret kuptimi i drejtë i normës juridike penale. Me anë të metodës kuantitative do të paraqiten në mënyrë statistikore numrat e rasteve në kuadër të veprimtarive kriminale të organizuara në Republikën e Shqipërisë, siç janë: trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabandimi i migrantëve, trafikimi i armëve, gjobëvënia, vrasjet me pagesë, krimi i organizuar kibernetik dhe pastrimi i parave.

### **4. Kontributi shkencor i hulumtimit**

Krimi i organizuar si një vepër penale është një fenomen social, dhe për këtë arsyе për hulumtimin e saj janë të rëndësishme metodat shkencore që zbatohen në hulumtimin e këtij fenomeni shoqëror. Në këtë punim, lënda e hulumtimit konsiston në praktikën penale dhe rolin e saj në luftimin e krimtit të organizuar. Kjo është një çështje mjaft e komplikuar shkencore, normative dhe praktike për shkak se krimi i organizuar është një fenomen social shumë konfliktual dhe negativ i cili, përveç masave të tjera sociale, duhet të luftohet edhe përmes sanksionimit penal. Bazuar në hulumtimin krahasues të legjisacionit vendor dhe konventave ndërkombëtare pritet të lokalizohen çështjet që, deri tani, nuk janë substancialisht të tematizuara

dhe të shpjeguara në mënyrë shkencore. Kjo ka rezultuar me një numër gjithnjë e më të madh të rregullave penale vendore dhe ndërkombëtare që nuk janë konsistente dhe të harmonizuara midis vete, dhe paraqesin vështirësi serioze në krijimin e zgjidhjeve De Lege Lata (E drejta siç është) dhe De Lege Ferenda (E drejta siç duhet të jetë).

Me qëllim të arritjes së objektivave kryesore të studimit, në këtë hulumtim do të përdoret një metodologji e përzier e hulumtimit. Hulumtimi do të jetë i gërshetuar ndërmjet metodës kualitative dhe metodës kuantitative. Qëllimi i përdorimit të këtyre metodave është mbledhja dhe analiza e të dhënave që ndihmojnë studiuesit për të shqyrtuar marrëdhëniet shkak-pasojë. Në rastin e këtij studimi pretendohet identifikimi i nivelit të krimtit të organizuar në Republikën e Shqipërisë, si dhe krahasimi i rolit të saj në bashkëpunimin ndërkombëtar në luftimin e krimtit të organizuar. Burimet që do të përdoren në këtë hulumtim do të jenë të shumëlojshme. Do të konsultohen raporte të ndryshme zyrtare të agjencive vendase, evropiane dhe ndërkombëtare rrëth krimtit të organizuar. Gjithashtu, do të realizohen intervista përkatëse me ekspertë të lidhur drejtpërdrejtë ose tërthorazi me luftimin e krimtit të organizuar, si gjyqtarë dhe prokurorë të kimeve të rënda, avokatë, ekspertë të policisë, ekspertë të krimtit të organizuar kibernetik, gazetarë investigativë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

## 5. Fusha shkencore e hulumtimit

Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në luftimin e krimtit të organizuar ka qenë dhe mbetet prioritet i Republikës së Shqipërisë. Ai përqendrohet kryesisht në shkëmbimin e informacionit cilësor, në përbashjen më të mirë të detyrimeve që vijnë nga marrëveshjet, aktet ndërkombëtare dhe iniciativat rajonale ku është pjesë edhe Shqipëria. Në koordinimin dhe shkëmbimin e vizitave që synojnë në rritjen e kapaciteteve dhe shkëmbimin e praktikave më të mira dhe pjesëmarrje në seminare dhe takime pune e kurse trajnimi. Një prioritet mbetet rritja e bashkëpunimit me strukturat homologe të rajonit, SELEC-un dhe EUROPOL-in, në mënyrë që të zhvillohen rezultate analitike, vlerësime kërcënimi dhe ndarje informacioni, dhe të kryhen operacione të përbashkëta duke përdorur forma të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar si dhe adresimi i objektivave që rrjedhin nga Konventa e Bashkëpunimit Policor, etj.

Kështu për shembull, gjatë vitit 2014 janë ndjekur procedurat përfinalizimin me sukses për nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe me vendet e rajonit dhe me vendet e tjera të Bashkimit Evropian e më gjërë, si dhe zbatimi i marrëveshjeve ekzistuese.

Janë ndjekur të gjitha procedurat dhe janë finalizuar me sukses:

- Protokolli Operacional ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Departamentit të Sigurisë Publike të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Italisë dhe kriji i një Task Force të Përbashkët është nënshkruar më datë 30 janar 2014;
- Marrëveshja ndërmjet Shqipërisë dhe Kroacisë për bashkëpunim policor është nënshkruar më datë 20 mars 2014;
- Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes Operacionale dhe Strategjike me EUROPOL-in është miratuar nga parlamenti më datë 20 mars 2014.
- Protokolli për sezonin turistik me Malin e Zi është nënshkruar më datë 30 maj 2014.
- Protokolli për sezonin turistik 2014 për patrullimet e përbashkëta me Policinë e Kosovës u nënshkrua më datë 28 qershor.
- Protokolli ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Maqedonisë mbi bashkëpunimin gjatë sezonit turistik 2015, u nënshkrua më datë 5 shtator 2014 në Tiranë, nga dy Ministrat e Punëve të Brendshme.
- Memorandumi i Bashkëpunimit për krijimin e Shoqatës së Shefave të Policive të vendeve të Evropës Juglindore, SEPCA ku Shqipëria merr Presidencën për vitin 2015, u nënshkrua më datë 26 nëntor në Beograd.
- Marrëveshja dypalëshe me Serbinë për lëvizjen e lirë, është nënshkruar më datë 10 nëntor 2014 në Beograd.

Janë në ndjekje marrëveshje dhe protokolle të tillë si:

- Marrëveshja me Malin e Zi për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës së Përbashkët të Bashkëpunimit Policor në Murriqan;
- Marrëveshja me Greqinë për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës së Përbashkët të Bashkëpunimit Policor;
- Marrëveshja për hapjen e PKK-së së Përbashkët Grabon-ZatrijebackaCijena, në kufirin me Malin e Zi;
- Protokolli mes Shqipërisë dhe Portugalisë për zbatimin e marrëveshjes së ripranimit mes Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian;
- Protokolli i Ripranimit me Greqinë;
- Miratimi i marrëveshjes dypalëshe me Bosnjë-Hercegovinën;

- Diskutimi dhe miratimi i marrëveshjes trepalëshe të bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë, Italisë dhe Greqisë për luftën kundër trafiqeve të paligjshme përmes detit;
- Marrëveshja mes Shqipërisë dhe Turqisë mbi bashkëpunimin e institacioneve të zbatimit të ligjit;
- Marrëveshja ndërmjet Shqipërisë dhe Sllovakisë mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm si dhe aktivitetave të tjera të paligjshme.
- Janë në ndjekje procedurat për nënshkrimin e një marrëveshjeje të përbashkët për fluturimet e përbashkëta për kthimet, e cila është gati për nënshkrim.
- Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet FBI-së dhe Policisë Shkencore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për shkëmbimin e gjurmëve të gishtërinjve, për të cilën pritet nënshkrimi i palës së SHBA-ve sepse Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit e ka nënshkruar këtë Memorandum Bashkëpunimi.

Në vijim të konkluzioneve të Forumit Ministror BE - Vendet e Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Budva, më datë 20.12.2013, në kuadër të marrëveshjes së përbashkët të ministrale për ngritjen e një rrjeti ekspertësh për armët e zjarrit në rajon, është në fazë negociatash një Memorandum Bashkëpunimi mes Shqipërisë, Serbisë, Kroacisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, për ngritjen e këtij grupi.

Gjithashtu, janë ndjekur edhe një numër aktivitetesh të rëndësishme të tilla si:

- Programi i Shkëmbimit i CEPOL ku nga Policia e Shtetit morën pjesë 5 oficerë të Drejtorisë së Përgjithshme në muajin maj 2014;
- Misioni i Guardia di Finanza dhe i Universitetit të Napolit për fluturimet me avion për identifikimin e parcelave të mbjella me kanabis. Kjo veprimtari u përfundua në fund të muajit shtator 2014.
- Pjesëmarrja në veprimtaritë e Iniciativës Globale për Luftimin e Terrorizmit Bërthamor është vlerësuar nga Departamenti i Shtetit për Sigurinë e Brendshme (HomelandSecurityDepartment) të SHBA, duke kontribuar në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve.
- Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me Përfaqësitë e Huaja Diplomatike në Tiranë dhe me homologët e huaj për mbarëvajtjen e vizitës së Papës.

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar për çështjet e antitrafikimit:

- Është nënshkruar më datë 4 dhjetor në Londër Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Brendshëm, i cili vepron nëpërmjet Zyrës së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrit të Punëve të Brendshme “Mbi intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore mbi përmirësimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit vullnetar të asistuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore”.
- Është nënshkruar më datë 8 dhjetor 2014, Protokolli Shtesë me Republikën e Malit të Zi për “Intensifikimin e Bashkëpunimit në Luftën kundër Trafikimit të Personave dhe për Përmirësimin e Identifikimit, Njoftimit, Referimit dhe Kthimit Vullnetar të Ndihmuar të Viktimave të Mundshme të Trafikimit”, në plotësim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Malit të Zi, për bashkëpunim në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm dhe aktiviteteve të tjera ilegale, miratuar me VKM-në Nr. 483, datë 16.7.2004.
- Gjatë viti 2014 po ashtu, janë zhvilluar disa takime me përfaqësues në nivel të lartë politik të vendeve të rëndësishme nga pikëpamje strategjike si Mbretëria e Bashkuar, SHBA, Itali, Francë, etj, ku temat kryesore të diskutimit kanë qenë qasja e përbashkët ndaj skllavërisë moderne, kthimi vullnetar dhe riintegrimi i viktimave të trafikimit, problematikat që shoqërojnë fëmijët e pashoqëruar.
- Në fund të muajit mars 2014 dhe në janar të vitit 2015, në Prishtinë u mbajtën takime të përbashkëta me Koordinatorin Antitrafik të Prishtinës dhe atë të Malit të Zi, si dhe ekspertë të fushës nga Kosova dhe Shqipëria, ku u vu theksi tek rivitalizimi i Protokollit Shtesë, si dhe u identifikuani mangësitë në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky protokoll për shkëmbimin e informacionit, në lidhje me identifikimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.
- Në muajin korrik 2014, u mbajt në Budva takimi i përbashkët me përfaqësues të policisë nga Shqipëria, Serbia, Kroacia, Italia, Mali i Zi dhe Maqedonia. Ky takim është pjesë e iniciativave të përbashkëta rajonale për të luftuar fenomenin e trafikimit dhe për të identifikuar, referuar e asistuar viktimat e mundshme dhe viktimat e trafikimit në territorin e të dy vendeve. Takimi synonte të sillte së bashku në Budva forcat e policive të

këtyre vendeve të atashuara në Mal të Zi për të asistuar strukturat e policisë së Malit të Zi gjatë sezonit turistik në Budva dhe në qendra të tjera turistike të Malit të Zi. Qëllimi i takimit ishte informimi dhe instruktimi i forcave të policisë mbi procedurat që duhet të ndiqen për identifikimin në kohë të viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe trajtimin e çështjeve që lidhen me trafikimin e personave. Përgjatë muajit gusht, forcat e policisë shqiptare vijuan patrullimet e përbashkëta me kolegë nga Mali i Zi, Serbia, Kroacia, Italia dhe Maqedonia.

- Koordinatori Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave për intensifikimin e bashkëpunimit në kuadër të marrëveshjeve dhe protokolleve të nënshkruara, aktualisht ka realizuar takime me homologët rajonalë të Malit të Zi, Maqedonisë, Kosovës, Greqisë, si dhe në nivel ndërkombëtar me Italinë, Francën, Zvicrën dhe Belgjikën për nënshkrimin e Marrëveshjeve në kuadër të luftës kundër trafikimit të personave.

Arsyet përse dështojnë agjencitë ligjzbatuese në goditjen e suksesshme të krimit të organizuar në Republikën e Shqipërisë lidhen me bashkëpunimin e dobët dhe mungesën e koordinimit midis agjencive të ndryshme ligjzbatuese, konsolidimin e mangët të institucioneve që shpesh i nënshtronen spastrimeve me karakter politik të ekspertëve sa herë ndryshojnë qeveritë, problemet e nivelit profesional, problemet financiare të shprehura në paga të ulëta dhe logistikë të dobët, mungesë vullneti, si dhe korruption apo komprometim të disa zyrtarëve (më së shumti përmendet policia e shtetit, e kufirit dhe ajo gjyqësore, e cila ndodhet në varësi të dyfishtë: administrative prej policisë dhe procedurale prej prokurorisë). Arsyet përse shoqëria shqiptare shfaqet ngurruese në denoncimin e krimit të organizuar gjykohen të lidhura ngushtë me mungesën e besimit tek institucionet, frikën ndaj hakmarrjes. Arsyet përse dështojnë agjencitë ligjzbatuese në goditjen e suksesshme të krimit të organizuar (pra, lidhjet familjare, farefisnore apo shoqërore).

## 6. Rezultatet e hulumtimit

Në këtë punim është vendosur një qasje gjithëpërfshirëse e studimit të rolit të bashkëpunimit ndërkombe tar në luftë kundër krimit të organizuar. Kjo qasje ka ardhur si rezultat i angazhimit maksimal të shteteve në luftë sa më të denjë kundër krimit të organizuar.

Në pjesën e parë të punimit bëhet përkufizimi i krimit të organizuar, duke përfshirë: vështrimin e përgjithshëm historik mbi krimin e organizuar, bashkëpunimet e ndryshme mbi krimin e organizuar, kuptimin dhe përkufizimin i krimit të organizuar, tiparet, karakteristikat dhe format e tij; përkufizimi juridiko-penal i krimit të organizuar sipas legjislacionit të shteteve të Ballkanit perëndimor; disa nga problemet e përkufizimit të krimit të organizuar; krimi transnacional dhe krimi i organizuar; krimi i organizuar ndërkombëtar dhe krimi i organizuar transnacional; krimi profesional dhe krimi i organizuar.

Në pjesën e dytë të punimit, rendësi të veçantë i kushtohet sanksionimit të krimit të organizuar sipas konventave ndërkombëtare dhe trajtimi juridiko-penal u tij në disa kode penale të shteteve të rajonit: veprimtaria e organizatave ndërkombëtare në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, trajtimi juridiko-penal të krimit të organizuar në republikën e Shqipërisë, trajtimi juridiko-penal i krimit të organizuar në republikën e Kosovës, trajtimi juridiko-penal i krimit të organizuar në republikën e Maqedonisë së Veriut, trajtimi juridiko-penal i krimit të organizuar në Serbi, trajtimi juridiko-penal i krimit të organizuar në Mal të Zi, trajtimi juridiko-penal i krimit të organizuar në Bosnjë dhe Hercegovinë, trajtimi juridiko-penal i krimit të organizuar në Itali, trajtimi i juridiko-penal i krimit të organizuar në Greqi, trajtimi juridiko-penal i krimit të organizuar në Bullgari..

Në pjesën e tretë të punimit, theksi vendoset në veprimtarinë kriminale të organizuara në republikën e Shqipërisë: trafikimi i drogës dhe llojet e drogës (heroina, kokaina, kanabis, drogat sintetike), trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabandimi i migrantëve, trafikimi i armëve, gjobëvënia, vrasjet me pagesë, krimi i organizuar kibernetik, pastrimi i parave..

Në pjesën e katërt, theksi vendoset në bashkëpunimin ndërkombëtar në luftimin e krimit të organizuar: luftimi i krimit të organizuar në SHBA, luftimi i krimit të organizuar në BE, luftimi i krimit të organizuar në Ballkanin perëndimor, bashkëpunimi ndërkombëtar i Republikës së Shqipërisë në luftimin e krimit të organizuar, bashkëpunimi ndërkombëtar policor në luftimin e krimit të organizuar.

Pjesa e pestë e punimit ka të bëj me organizata policore ndërkombëtare në luftimin e krimit të organizuar: Evropoli dhe struktura organizative e Evropolit, bashkëpunimi në mes Shqipërisë dhe Evropolit, Interpoli, roli i Interpolit në luftimin e krimit të organizuar, bashkëpunimi në mes Shqipërisë dhe Interpolit.

Ekstradimi si formë e veçantë e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale trajtohet në pjesën e gjashtë të këtij punimi: parimet mbi ektradimin, ekstradimi në kuadër të së drejtës ndërkombëtare, ekstradimi në kuadër të BE, procedura e ektradimit, ekstradimi në legjislacionin dhe praktikën e Republikës së Shqipërisë.

Në kapitullin e shtatë, kandidati prezenton rezultatet e hulumtimeve të statistikave mbi krimin e organizuar dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në Shqipëri dhe tri hallkat e sistemit gjyqësor, gjykata, policia dhe prokuroria, pjesë e cila më gjërësisht përfshin: të dhënat e përgjithshme, statistikat gjyqësore mbi krimin e organizuar në Shqipëri 2014-2018, statistikat policore mbi krimin e organizuar 2014-2018, statistikat policore mbi trafikimin e drogës në Shqipëri 2014-2018, statistikat policore mbi trafiqtet e paligjshme në Shqipëri 2017-2018, statistikat policore mbi pastrimin e parave, krimin ekonomik-financiar dhe krimin kompjuterik në Shqipëri 2017-2018, statistikat e prokurorisë së përgjithshme mbi krimin e organizuar në Shqipëri 2017-2018..

Në fund të punimit, kandidati ka paraqitur konkluzionet dhe rekomandimet, të cilat janë të bazuara në gjetjet e punimit. Përveç kësaj, kandidati ka përdorur dhe konsultuar literaturë e pasur, e brendshme dhe ndërkombëtare.

## **7. Kontributet kryesore shkencore të kandidatit**

Gjatë periudhës së studimeve kandidati ka marr pjesë në disa konferenca tematike për problematikën e në fjalë dhe në mënyrë aktive punon në hulumtime tjera lidhur me këtë problematikë. Angazhimi i kandidatit përfshinë pjesëmarrje dhe prezentim të punimeve shkencore në disa konferenca shkencore, publikim të punimeve në revista shkencore me karakter ndërkombëtar. Pjesë e arritjeve shkencore është edhe vizita studimore me qëllim kërkimi dhe hulumtimi lidhur me tezën e doktoraturës në Universitetin Aleksandër Moisiu, fakulteti juridik në Durrës.

## **8. Fusha shkencore në të cilën do të aplikohen rezultatet**

Sipas trajtimit që ka kjo tezë e disertacionit, duke u bazuar në bazën teorike e cila përfshin krimin e organizuar si dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar të Shqipërisë në parandalimin dhe luftimin e krimit to organizuar, konsiderojmë se kandidati ka dhënë kontribut të madh në analizën e detajuar të cilën e ka shpalosur në punimin e disertacionit. Në pjesën e

fundit të disertacionit, kandidati ka përfshirë pjesën e rekomandimeve, në të cilën cekën sferat ku dot mund të shërbejnë rezultatet e këtij punimi.

Si përfundim, konsiderojmë se ky punim do të shërbej si bazë në sfera të ndryshme, si në aspektin e avancimit të gjetjes së mekanizmave kryesore për luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar, po ashtu edhe në azhurimin e legjislacionit në të këtë drejtim, duke e përshtatur me standarde ndërkombëtare.

Ky punim rekomandon që rezultatet e ofruara të përdoren si bazë për ndryshime strategjike dhe ndryshime të politikave, të cilët do të ndikojnë në formulimin e strategjive dhe realizimin e aktiviteteve për luftim dhe parandalim të krimit të organizuar në republikën e Shqipërisë.

## **9. Hulumtime të mundshme në të ardhmen**

Duke e marr parasysh atë se kjo temë nuk ka qenë mjaftueshëm e trajtuar në Shqipëri, konsiderojmë se ekziston mjaftë hapësirë për t'u studuar më gjërësisht, me qëllim për t'u analizuar nga fella akademike dhes studiues të ndryshëm. Fillimisht duhet studuar aspekti i rregullimit ligjor të luftimit dhe parandalimit të krimit të organizuar dhe formave të tij, si dhe të ofrohen rekomandime nga studiuesit e sferës ligjore. Po ashtu, duket analizuar funksionimin e institucioneve shtetërore si dhe institucioneve tjera që mund të kontribuojnë në drejtim të luftimit dhe parandalimit të krimit të organizuar.

Studiuesit nga sfera kriminologjike, veçanërisht që trajtojnë tematika të krimit të organizuar dhe formave të tij, duhet të ofrojnë sugjerime se si duhet të shfrytëzohen aplikacionet apo mekanizmat më efikase për të luftuar në mënyrën më të mirë e mundshme krimin e organizuar. Në këtë drejtim, duhet ti kushtohet vëmendje e veçantë ndikimit të bashkëpunimit regional dhe atij ndërkombëtar në luftë kundër krimit të organizuar.

## **10. Përfundim me propozim**

Komisioni konstaton se punimi me temë “Roli i Shqipërisë në bashkëpunim ndërkombëtar në luftimin e krimit të organizuar”, i kandidatit mr.sc Anton Bardhaj i plotëson kushtet që të punohet si punim i pavarur shkencor dhe sipas metodologjisë së propozuar, është adekuat për vlerësuar aftësitë e kandidatit si hulumtues i pavarur shkencor.

Komisioni vlerëson se punimi i plotëson kushtet e parapara me Rregulloren për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhes studimit në ciklin e tretë të studimeve të doktoraturës në Universitetin e Tetovës për fillimin e punimit shkencor të temës së doktoraturës.


Komisioni i propozon Këshillit mësimor-shkencor të fakultetit Juridik që të sjell vendim për miratim të këtij raporti dhe të vazhdohet me procedurat e mbrojtjes së tezës së doktoraturës "Roli i Shqipërisë në bashkëpunim ndërkombëtar në luftimin e krimit të organizuar".

Komisioni:

1. Prof. dr. Qebir Avziu, kryetar




2. Prof. dr. Jusuf Zejneli, anëtar



3. Prof. dr. Ferat Polisi, anëtar



4. Prof. dr. Ali Musliu, anëtar



5. Prof. dr. Afrim Osmani, mentor

